

NAMIK DOKLE  
**ATJE KU DIELLI LIND DY HERË**  
SAGA E GORËS

---

TRILOGJI

Trilogjia

ATJE KU DIELLI LIND DY HERË  
SAGA E GORËS

*Vajzat e mjegullës*  
*Ditët e lakuriqëve të natës*  
*Gora pa zogj*

NAMIK DOKLE

ATJE KU DIELLI LIND  
DY HERË

SAGA E GORËS

trilogji

BOTIMET TOENA

Botimi i parë: Janar 2026

Botimi i dytë: Maj 2026

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Ana Kove

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

Foto e kopertinës ballore: Admir Idrizi - *Gorë, lule dhe borë*

ISBN 9789928960603

© BOTIMET TOENA dhe AUTORI

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

## PARATHËNIE

Kur Zoti e pyeti goranin “Nga po vjen?”, ai u përgjigj “Nga fundi i botës”. Dhe ku është kjo Gorë, banorët e së cilës mendojnë se është në fund të botës? Është në mes të Europës. E njohur me këtë emër që në vitin 1348 në dokumentet e shkruara të Ballkanit, ajo u bë viktimë e historisë; krahinë me 29 fshatra, me një etnokulturë shpirtërore dhe materiale të veçantë, me territor kompakt brenda të cilit jetojnë vetëm goranë, për fat të keq, pas Luftës së Parë Botërore, u nda në tri shtete ballkanike: 9 fshatra në Shqipëri, 18 në ish-Jugosllavi (sot në Kosovë) dhe 2 në Maqedoninë e Veriut. Kjo ndarje u bë edhe më e egër gjatë periudhës komuniste, kohë kur goranët thoshin “Tito andej, Enveri këndej, mjegulla në mes!”.

Po si ka mundur të mbijetojë kjo kulturë e veçantë, kur në asnjë libër nuk shkruhej për të, në asnjë shkollë nuk mësohej, në asnjë radio apo televizion nuk transmetohej?! Ajo ka jetuar dhe jeton përmes këngëve, baladave dhe legjendave të saj, përmes traditave dhe zakoneve të mira mijëravjeçare. Sot e kësaj dite, në shumë fshatra të Gorës, vajzat mblidhen çdo mbrëmje para portave dhe këndojnë këngët e tyre lirike, duke kuvenduar me djemtë, me zogjtë, me yjet dhe hënën, i shprehin qiellit dhe tokës dëshirat dhe vuajtjet, ëndrrat dhe zhgënjimet e jetës.

Kësaj jete i kushtohet "Saga e Gorës" e shkrimtarit Namik Dokle.



1

VAJZAT E MJEGULLËS

roman



*Nënës,  
më shumë se gjithkujt.*



Jesene mëgle panale  
Putnicam putoj kazhujet...

Ranë mjegullat e vjeshtës,  
Udhëtarëve udhët u tregojnë...

KËNGË GORANE



# PJESA E PARË



## 1.

Edhe sot, kur kanë kaluar pesëdhjetë e shtatë vjet, në gjithë qenien time përsillet ajo piskamë e egër, e trishtë dhe hakmarrëse, që e preu natën mespërmes dhe i bëri një, qiell e tokë. Yjet u fikën në çast dhe unë mbeta i vetmuar në errësirë, duke u dridhur nga diçka që shkonte përtej tmerrit. Po shihja një ëndërr atë mëngjes të ftohtë dimri, kur dita ende kishte frikë të hapte sytë; një ëndërr të çuditshme që më kishte futur mornica në trup, megjithëse isha pranë një zjarri të madh. I prekja flakët me duar, afrohesha, por sa më shumë u avitesha, aq më tepër mërdhija. Hyra i tëri mes flakëve dhe përsëri asgjë, ftohtë... ftohtë. Në çastin kur u rrasa mes zjarrit të ftohtë, dëgjova piskamën që s'kuptohej nga vinte, nga toka apo nga qielli. Dola në kjustër<sup>1</sup> bash kur u fikën të gjithë yjet nga frika e asaj ulërime therëse dhe dridhësja i tëri, pa kuptuar se ku kishte shkuar dera e dhomës. “Futu brenda shpejt!”, më thirri babai dhe më tërhoqi si një trastë me bar të njomë. Nëna më mbuloi në shtrat me përkujdesje, por unë nuk u ikja dot të dridhurave që më ndiqnin nëpër trup, deri në brendësi të kraharorit. “Çfarë ishte?”, pyeti nëna. “Arushat”, tha babai. “Po vajtojnë nënën e vrarë... do ta gjejë ndonjë bela këtë fshat që vrau arushën.”

Këto fjalë më drodhën edhe më shumë se ulërima e arushave jetime. Ato tashmë kishin pushuar, ose ishin futur në thellësi të ahishtës, por piskama e tyre ende sillej brenda meje dhe, s'di pse, më dukej sikur kokërdhokët

---

<sup>1</sup> Kjustër – hayat.

do të më kërcenin nga sytë e do të pëlcsnin mbi tokë. Babai rrëmbeu gërshërët, me të cilat qethnim delet, dhe doli gjysmë i veshur nga shtëpia. Unë kapa duart e nënës dhe pata frikë t'i lëshoja, derisa u kthye babai. Ai i zgjati nënës diçka të zezë e të vockël, sa një gisht fëmije të porsalindur dhe me zë të ngjirur i tha:

“Bëja një bazibén me këtë”.

“Çfarë, çfarë është kjo?”

“Thoi i Arushës”, tha babai. “Qepja në një kind dhe varja te mitani<sup>1</sup>. Do t'i largohet frika e arushës. Ishte thoi i fundit, të tjerët janë trembur para nesh dhe i kanë marrë.”

“Atje është ende?”, pyeti nëna.

“Atje. Por sot do ta marrin, se ka filluar të mbajë erë.”

Arushën e kishin vrarë kufitarët tri ditë më parë. Në sheshin përpara Xhamisë së Djegur kishin ngritur një skeleri me trungje ahu dhe e vunë mbi të. I gjithë fshati u shkund për ta parë. Shumë gra kishin harruar të vishnin edhe terlikun e zi nga nxitimi. Më pas erdhën edhe nga mëhallët e tjera, ndërsa të nesërmen edhe nga fshatrat rrotull nesh. Unë shkova disa herë dhe në retinën e syve më mbetën thonjtë e zinj dhe sytë e ngrirë, që nuk e kishin të bardhën siç e kanë njerëzit. Ata që vinin aty nuk flisnin, tundnin kokën të menduar dhe largoheshin; ndoshta edhe ata mendonin se pas vrasjes së arushës, do ta gjente belaja fshatin tonë. “Kush e vrau? Ku e vranë?”, pyesnin. Kushdo që gjendej afër, përgjigjej shkurt: “Në kufi”.

Ushtarët që e kishin qëlluar qëndruan aty për disa orë, por vetëm ditën e parë, kur e zvarritën me ndihmën e një kali deri në mes të fshatit. Ditën e dytë gratë dhe vajzat nuk erdhën të mbushnin ujë në Topillo, çezma me

---

<sup>1</sup> Mitan – lloj veshjeje si xhamadan, por me mëngë.

ujin më të mirë në fshat, që rridhte vetëm pak hapa larg nga skeleria e viktimës. Një shoku im mori një gur nga rrënoja e Xhamisë së Djegur dhe e vërviti në drejtim të arushës. Por njëri nga burrat, Olloman Amerika, e mori gurin që ra në këmbët e prapme të saj. “Nuk qëllohet me gurët e xhamisë”, tha duke ngrysur vetullat dhe e hodhi përsëri në grumbullin e rrënojës.

Piskama e arushave jetime u dëgjua vetëm natën e tretë. “Ndoshta tani e kanë ndier erën e së ëmës”, tha nëna, pa shikuar as nga unë dhe as nga babai. U përkujdes edhe pak të më mbulonte mirë nga shpatullat dhe, me një zë të lodhur, tha se do të më zgjonte për të shkuar në mulli. Nuk ka mbetur asnjë gisht miell, u shfajësua. Ulërima e arushave vazhdoi deri në agshol<sup>1</sup> të asaj dite të mjegullt e të ftohtë.

---

<sup>1</sup> Agshol – zbardhëllim.

## 2.

Edhe unë e dija që s'kishim më miell në magje dhe ishim detyruar, si thonë, të hanim edhe bërcakë<sup>1</sup> e bërsi kungulli. Një ditë më parë babai më pat dërguar në Orgostë, te Murseli, pa më thënë asnjë fjalë, asnjë porosi. Shko dhe pyet ku e ka shtëpinë. Vetëm kaq. Ishte hera e parë që shkoja atje, buzë lumit që vinte nga Kosova, diku nga malet e Sharit. Vetëm kur hyra në pyll më zuri frika dhe fillova të këndoja me zë të lartë për të mposhtur rrumbullimën ndjellakeqe të ahishtës. Nuk dëgjova ulërimë currani apo arushe, por disa herë më ngriu zemra nga lepujt që kërcenin hopthi në anë të rrugës dhe kalonin në krahun tjetër.

“Më prenë rrugën lepujt, është ters”, i thashë Murselit kur ia gjeta shtëpinë.

“Jo, mos u tremb, lepuri është i lehtë dhe nuk është ters.” Ai nuk më pyeti fare përse kisha vajtur në shtëpinë e tij. Më dërgoi babai, i thashë, por ai nuk foli, futi ca drunj të tjerë në oxhak dhe më tha të afrohesha. Afti i prushit ma shkriu frikën. “Ke mërdhit më shumë nga frika se nga dimri”, më tha. Nuk e di sa kohë qëndrova duke u ngrohur dhe sa herë pyeta veten pse kisha shkuar aty. Murseli, një burrë i qetë, me mjekër të shkurtër, me sytë që gjithmonë kishin një lot në qepalla prej tymit të oxhakut, hynte e dilte, fliste në të rrallë ndonjë fjalë dhe thithte çibukun e tij. Atëherë kur nuk e prisja, në dhomë hyri një nga nusët e shtëpisë, një bucajkë<sup>2</sup> e gjatë dhe më vuri sofrën

<sup>1</sup> Bërcakë – kungull i papjekur.

<sup>2</sup> Bucajkë – grua e kolme.

pranë këmbëve. Doli dhe u kthye me një tepsi me petë kallamboqi, që nxirrte avull me aromë lakre turshi. “Do hamë tani, unë dhe ti, se të tjerët janë nëpër punë”, dhe Murseli u afrua pranë sofrës. “Prandaj më paska dërguar babai”, mendova. Kishte ditë që shtëpinë tonë e kishte prerë uria. Tokat që kishim nëpër bokza<sup>1</sup> e bërlina<sup>2</sup> nuk na ngopnin. As racionet që shpërndante shteti ndonjëherë nëpër fshatra. Vite të tjera babai shkante në Has për të kallajisur enët dhe sillte prej andej drithë e ushqime të tjera, por që prej dy vjetësh nuk e bënte më atë rrugë as ai, as shokët e tij. “Më mirë të vdesim nga uria se nga morrat”, thoshte nëna.

Tre vjet më parë njërin nga kallajxhinjtë e zuri tifoja e morrit dhe shtëpinë e tyre e mbërthyen me listela për disa javë. Edhe ne na mbuloi tmerrri. Po sikur ta zërë babanë? Ditën kaloja nga shtëpia e mbyllur me listela e gozhdë për të marrë vesh si ishin ata brenda, a mos kishte vdekur ndonjë, a mos i kishin shkukur listelat nga dritaret dhe dyert, kurse natën shihja ëndrra me morra që më bënin të zgjohesha i tmerruar. Më e keqja nga ëndrrat, ndoshta prandaj e mbaj mend ende, ishte ajo kur shkoja të kullosja delet në bjeshkë, por ato shndërroheshin në morra të zinj, të mëdhenj sa vetë delet dhe e faronin bjeshkën krejt.

“Ha, ha”, më nxiste Murseli, që pandehte se unë kisha turp të haja në shtëpi të huaj, ndërkohë që mua m’u fanitën mbi sofër delet e zeza. Por shpejt i harrova ato dhe goja m’u mbush me aromën e misrit e të lakrës. Ndonëse pa zë, me shpirt e falënderoja Murselin e mirë, atë nusen e bukur që solli sofrën dhe tepsinë me petë, të cilën me siguri vetë e kishte pjekur, babanë që më dërgoi në këtë

---

<sup>1</sup> Bokza – shpat mali.

<sup>2</sup> Bërlina – tokë gurishtore.

fshat të vogël të ngopja barkun e ta ngrohja stomakun e rrudhur nga uria, që kishte rënë në shtëpinë tonë. Kur u ngopëm edhe unë, edhe Murseli, në tepsi kishin mbetur akoma ca petë. Sikur t’i merrja e t’ia çoja nënës?! “Tani mund të shkosh”, më tha Murseli. Zbrita shkallët e drunjta dhe pashë mushkën tonë të ngarkuar jo me bremak<sup>1</sup>, por me dy kosha të thurur me thupra lajthie, mbushur plot me misër të pashkoqur. I miri Mursel! Babai më kishte dërguar të merrja drithë, kurse ai më mbajti me muhabet derisa u poq peta. Nuk zbriti, por më përshëndeti nga çardaku i shkallëve në katin e dytë të shtëpisë dhe thirri: “Mos u tremb nga lepujt!”.

Përpiqesha të fitoja pak trimëri, por ajo avullonte shpejt nga mendja ime që kujtonte gjithfarë ngjarjesh për ata njerëz që rravgonin dimrave për të kërkuar bukën e shtëpisë, mirëpo herë-herë i shqyente ujku, u dilte kaçaku e hajduti dhe i vriste, i zinte furtuna dhe i gjenin kallkan pas shtatë ditëve ose, edhe nëse u shpëtonin rreziqeve, kur mbërrinin në shtëpi i gjenin fëmijët e vdekur nga uria, sepse ishin vonuar shumë në rrugën e bukës. E kishim një grua të tillë në fshat që, kur i gjeti dy djemtë e vdekur, filloi t’u çonte çdo ditë bukën te varri, vajtonte e ulërinte dhe pastaj belbëzonte: “Hani shpirtrat e nënës, hani se mos ju ftohet buka!”.

---

<sup>1</sup> Breماك – gjysmëthesi me drithë.